VENDIM
Nr.189, datë 19.5.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.88, DATË 8.9.2003 TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE PAGAVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE"

Në mbështetje të nenit 16 pika 4 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", dhe të nenit 88 të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr.88, datë 8.9.2003 të Kuvendit të Shqipërisë, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. Në pikën I, fjalët "prej 30 vetësh" zëvendësohen me fjalët "prej 35 vetësh".

II. Në tabelën e pagave të punonjësve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me emërtimin "specialist", me pagë sipas kategorisë IV-a.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi